

KARTELE INFORMATIVE

AL011525

1. Emri i shërbimit	Licencimi i Agjencive të Administrimit Kolektiv			
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Kryen procedurat e shqyrtimit të dokumentacionit të organizatave për licencim, si Agjenci Administrimi Kolektiv në zbatim të ligjit 35/2016 dhe udhëzimit në zbatim të tij me nr. 5166, datë 20.10.2016, Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të tjera shtesë në sqarim të kriterëve të parashikuara në nenin 133, si dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurës së marrjes së licencës ose ripërtëritjen e saj, në bazë të nenit 134, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to" dhe i paraqet ministrit përgjegjës për të drejtën e autorit, kur është e mundur, dy propozime për miratim licencimi. Ministri përgjegjës për të drejtën e autorit miraton një nga kandidaturat e propozuara; Në këtë shërbim që ofron Ministria e Kulturës aplikantët e interesuar plotësojnë formularin e aplikimit dhe të gjitha kriteret e tjera që përcakton ligji organik dhe udhëzimi i ministrit nr. 5166, datë 20.10.2016.			
3. Çfarë ofron ky shërbim?	Me qëllim rritjen e transparencës dhe të besueshmërisë në procesin e licensimit/ri-licensimit të agjencive të administrimit kolektiv në fushën e të drejtës së autorit, përfshirjen e sa më shumë subjekteve në zbatim të parimit të konkurrenshëmërisë si dhe në favor të mbrojtjes maksimale të interesave të kategorive të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, Ministria e Kulturës inkurajon të gjithë subjektet e interesuar të aplikojnë për licensim në fushën e administrimit kolektiv, në Drejtorinë e të Drejtës së Autorit pranë Ministrisë së Kulturës.			
4. A jam përfitues?	Organizatat Jofitimprurëse, shoqatat e ndryshme që aplikojnë për pajisjen me licencë në fushën e menaxhimit kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to.			
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?
	1	Dëshmitë dhe kriterë profesionale të AAK-së dhe kontraktimi për kryerje të funksioneve dhe shërbimeve specifike)	Organizatat Jofitimprurëse	Po
	2	Ekstrakt i lëshuar nga gjykata për regjistrimin e saj si OJF, organet drejtuese dhe kolegjiale	Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Po
	3	Kontratat për përfaqësim reciprok të nëshkruara me agjencitë e huaja.	Organizatat Jofitimprurëse	Po
	4	Lista e anëtarëve dhe të drejtat e autorizuara prej tyre.	Organizatat Jofitimprurëse	Po
	5	Mandat pagesa	Banka	Po
	6	Formulari i aplikimit	Ministria e Kulturës	Po
	7	Statuti i Agjencisë të miratuar nga Gjykata kompetente	Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Po
	8	Ekstrati	Qendra Kombëtare e Biznesit	Jo
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse Ministria e Kulturës/ Drejtoria e të Drejtës së Autorit (DDA)	Qyteti Tiranë	Adresa Rr" Aleksandër Moisiu" Nr. 76, ish-Kinostudio "Shqipëria e Re" Tiranë	Orari E hënë - e enjte, 08:00 - 16:30 E premte: 08:00 - 14:00
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1 Ofrohet informacion mbi shërbimin	Niveli 2 Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Niveli 3 Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Niveli 4 Shërbimi ofrohet tërësisht online
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë 3 milion lekë (të vjetra)	Tarifa shtesë Nuk ka	Tarifa Online	Mënyra e pagesës Në një bankë (ose në disa banka), jashtë institucionit
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	45 ditë			
10. Çfarë përfitoj?	Licencë			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	3 vjet			
12. Ku e marr?	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input type="checkbox"/>	E-albania <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Ministria e Kulturës (MK)			Orari
	Kontaktto në:			

14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	<i>E- albania: e-albania.al</i> <i>ADISA web: www.adisa.gov.al</i> <i>ADISA email: Informacion@adisa.gov.al</i> <i>DDA web: www.dda.gov.al</i> <i>Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: 0800 0118</i>	<i>Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike:</i> <i>E hënë - e premte, ora 08:00 - 19:00</i>
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	<i>Në sportele</i> <input checked="" type="checkbox"/> <i>Me postë</i> <input checked="" type="checkbox"/> <i>Web-i i Institucionit</i> <input type="checkbox"/> <i>Me e-mail</i> <input checked="" type="checkbox"/> <i>Në platformën "Shqipëria që duam"</i> <input checked="" type="checkbox"/> <i>Link: www.shqiperiaqeduam.al</i>	
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	<i>Ligji 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to" si dhe udhëzimit në zbatim të tij me nr. 5166, datë 20.10.2016 "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të tjera shtesë në sqarim të kritereve të parashikuara në nenin 133, si dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurës së marrjes së licencës ose ripërtëritjen e saj, në bazë të nenit 134, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to".</i>	